



Regjistri Elektronik për Njoftimet
dhe Konsultimet Publike

Njoftim për konsultim publik për projekt dokumentin strategjik: “Strategjia e Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri”

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Postuar më: 31.07.2017

Ministria

e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave shpall për konsultim publik, projekt-dokumentin strategjik: “*Strategjia e Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri*”.

Qëllimi

(Draft) Strategjisë së Ujitjes dhe Kullimit në Shqipëri:

Strategjia

bazuar në analizën dhe gjëndjen ekzistuese, identifikon pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe rreziqet për ujitjen, kullimin, digat dhe rezervuarët si dhe mbrojtjen nga përmbytjet, duke sugjeruar misionin për nën- sektorët e ujitjes dhe kullimit brenda fushës së veprimit të (MBZHRAU), që ka të bëjë me optimizimin e të gjithë investimeve në ujitje, kullim dhe mbrojtjen nga përmbytjet me qëllim zgjerimin dhe bërjen të qëndrueshme të sistemeve të ujitjes, përbushjen e nevojave për kullim dhe mbrojtjen e popullsisë dhe pronave nga përmbytjet, nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm dhe produktiv të të sistemeve të ujitjes dhe kullimit, përmirësimin eficient të ujit dhe shpërndarjen e barabartë, krahas me reduktimin e rrezikut nga përmbytjet dhe shkatërrimit të digave, duke dhënë një projektion se si duhet të jetë ujitja dhe kullimi në 10 deri 20 vitet e ardhëshme.

Qëllimi i procesit

te konsultimit publik:

Rekomandimet

dhe komentet nga qytetaret, grupet e interesit do të ishin një kontribut i vyer për të hartuar një dokument strategjik gjithëpërfshirës. Ju ftojmë të dërgoni komentet dhe rekomandimet Tuaja, brenda 20 ditëve pune nga

data e njoftimit për procesin e njoftimit e te konsultimit publik, në adresën: erola.rada@bujqesia.gov.al

Organizimi

takimit:

Më datë 29.08.2017, në Ministrinë e

Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ora 11, në sallën e mbledhjeve në katin e tretë, do të zhvillohet takimi publik përmbledhës ku jeni të lutur të merni pjesë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Dokumenta:

- Draft strategjia e ujites dhe kullimit ne Shqiperi
- Njoftim per draft strategjine e ujites dhe kullimit ne Shqiperi

Diskutimet
